

BIBLIOTEKA
SHTETIT

8SH-1

N 14



JULIA NAÇI

**KU
GJEU
POEZINË
vjersha**


8SH-1
N 14

JULIA
NAÇI



**KU
GJEJ
POEZINË**

VJERSHA



SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

RRUGËS PËR NË PUNË

Kjo rrugë e dashur është për mua
si vetë njerëzit e saj.
Çdo mëngjes herët i takoj
gëzimet tona bashkë i ndajmë.

Janë vajzat e bukura të qelqit
pranverën kanë në sy,
i pleksim ëndrrat tona
për punët, stërvitjen, poezinë...

Ato në qelq pikturojnë lule,
lule të kuqe, të kaltra.
Në prodhimet e bukura të tyre
këputen lulet e mollës, të bardha.

Ngjyrat e zemrës derdhin ato,
pranverën e vendit tonë
dhe në stërvitje së bashku ne
pushkën fort shtrëngojmë.

TE JU PO VIJ USHTARE

Ju, valë të kaltra, ju, pulëbardha,
nuk më njihni, jam shoqja juaj
me pushkë në krah e yllin në ballë;
unë ushtarja mbroj këngën tuaj.

E njihnit mirë ju gjyshin tim,
ju e përcillnit larg në udhëtime.
Vaporë ngarkonte i zbathur deri në gjunjë,
gjyshi im i mirë, gjyshi halleshumë.

Unë ushtarja sodit bukurinë e valës,
djersën e gjyshit, valë e kripur mban;
ëndrra e tij hapur nëpër dallgë
çel duarve të mia e bardhë, e kaltër...

KU GJEJ POEZINË

Mbështeta kokën në gjoksin e malit
dhe ndjeva gurgullimën në burime,
ndjeva forcën e burrit e të djalit
dhe me freski mbusha këngën time.

Mbështeta kokën në kraharonin e fushës
dhe ndjeva pemët të lëshojnë sythe,
ndjeva aromën e duarve të nënës dhe motrës.
Atëhere thashë: «Pranvera rrit këngën time».

Mbështeta kokën në tokën mëmë
dhe ndjeva si bulojnë miliona këngë.

ERA E REVOLUCIONIT

Kur fryjnë erërat e forta,
kur natyra gulçon e pyjet oshëtijnë,
gjithçka që ka rrënjët e dobëta,
si pemët e kalbura;
gjithçka e gjallë që ka plevitin brinjë më brinjë,
si mendimet e plakura;
gjithçka që s'është përgatitur për në stuhi,
sikur të mos ekzistonte, shndërrohet në pluhur, në hi...
Më e forta e erërave,
Era e Revolucionit,
armiqtë e kohës i bën tym e byk.

NË STËRVITJE DIMRI

Në palcën e dimrit, në mes të janarit,
veç uniformat tona gjelbërojnë.
Acari na zbardh kaçurrelat e ballit
e ylli në kapele më shumë ndriçon.

Mali i Dajtit nuk ka heshtje,
nga blerimi ynë sikur po çel,
kjo kënga e pushkëve tona
po zgjon në dimër pranverën e re.

VITET NUK PLAKIN TRIMËRINË

Jo, vitet nuk e plakin trimërinë,
as lodhjen nuk e ndien trupi juaj,
atë që dhatë ju për lirinë
në këngë Shqipëria do ta ruaj.

I puthni djemtë tuaj sot ushtarë,
bekim i buzëve zjarresh të zhuritur,
një porosi, një pushkë dhe yll zjarr
mes yjesh për të nesërmen e ndritur.

F Q I N J Ë T

Banonin në rrugën e vjetër të qytetit karshi për karshi
një vajzë dhe një djalë.

Thuhej se ndër djemtë më i mirë ish ai
dhe ajo më e mira vajzë.

Këtë ata akoma mund të mos e dinin,
por pa u parë çdo ditë s'mund të rrinin.

Ishte një takim i thjeshtë, por i gjithfuqishëm,
si takimi i agimit kur zbardh mëngjesi me tokën.

Ai ishte i pari që hapte dritaren
dhe ajo e para në atë zgjim shplekste flokët.

Një mëngjes papritur fryu një erë e fortë,
dritaret e tij mbetën hapur si dy qepalla,
ai nuk ishte në dhomën e tij atë mëngjes,
ajo më kot vështroi gjatë rreth e rreth...

Në rrugë krisma, në male gjëmime,
ai nëpër krisma e gjëmime u derdh
pas zërit të atdheut që thirri bijtë në luftime.

As ajo nuk u duk në shtëpi të nesërmen në mëngjes.

Liria

i solli lapidarë të përjetshëm fqinjët, heronj të lagjes
sime.

VALLJA NË TEPSI

— Gati, — thërret xhelati, —
ç'amanet do thuash?

— Një valle, mor qena,
në tepsi do luaj!

— Sillni një tepsi
Për Telo mavinë,
si të hedhë vallen,
Telua do mbyllë synë!

Telo, si qëndron në këmbë?
Po të pyet me sy fshati,
Telo, mishrat t'i paska ngrënë,
qeni i qenërve, xhelati!

Rrotulloi njëherë tepsinë
e në të i futi këmbët,
si ndër festa zu vërtitej,
vdekjen trembi ai me këngë.

Ti hedh vallen e këndon, Telo.
Nuk dëgjon, xhelati ulërin.
Ti popullin trimërove, Telo,
ndeze zemra djaloshare për liri!

BIJA E BJESHKËVE

Kjo ngjarje është e thjeshtë,
nga jeta dje e mora unë,
atje po e kthej prapë.
Për ty, shoqja ime, Ela, po tregoj
si zbritë nga bjeshkët e larta,
hodhe krahëve kapotën e murmë
dhe shkele mendimet e ashpra.
Kur zbritë nga bjeshkët,
ato gjelbërimin të shturën mbi supe,
në çast ndjeve se s'ishe thjesht vajzë,
por një krismë pushke.
Hodhe hapin e matur e sigurt
e ëndrra larg vrapoi,
në rreshta ushtarësh u fute,
ballit ylli zjarr vezulloi.
Por ç'ishin ata në malësi
që çorrën faqet, supet ngritën
dhe midis tyre pëshpëritën:
«Uaa, vajza aficere?!».

Dhe djaloshi që doje
nuk doli të përcolli.
Ai rrinte i heshtur
dhe gjurmët s't'i lexoi.
Së shpejti ai do nisej ushtar
dhe në repart do mësonte shumë.
Ai të donte dhe nuk dyshove ti
as në bisedë kur fjalët s'i peshonte,
as kur i lumtur me çifteli këndonte.
Dy sytë e tij ishin si zjarret e barinjve
që ndrijnë në një shpat
dhe atë dritë ti
e krahasove shpesh me dritën e yjeve
të bukur dhe të zjarrtë.
Por ja u zbeh gjithë ajo dritë
veç në një ditë
dhe ishte ditë pranvere
kur ty, Ela, të thirrën,
kur të thanë: — O bijë e bjeshkëve,
do të bëhesh oficer!
Ti më parë u bërë flutur e lehtë,
në fshat vrapove,
mbi krah iu derdhe si ujëvarë
plot dritë e ngjyra
atij që dashurove...
Por ai ç'pati
që vetullat i mblodhi?
Diçka po kujton...

Stërgjyshi, gjyshi dhe babai i tij
të nderuar ishin,
se para çdo armiku nxorën pushkën
dhe para grave grushtin.
Hej, hej, si ndërroi zamani,
si u përzien shekujt
dhe majë shkëmbinjve po rritej jargavani
dhe burri që nga shqota nuk ish prekur,
tani duhej të rrinte i urtë, i heshtur
siç rri veç muri,
të rrinte urtë e butë
i bindur, i përlulur
ai që jo diku në ndonjë lëndinë të butë kish lindur,
por rrëzë një shkrepit,
ai që qysh pesë vjeç
si trim mes natës ish sulur?
Jo, ky do ish akoma ca më keq
përjetë ushtar
dhe gruaja në mëngjes, drek' e darkë
do t'i këndonte refrenin e mallkuar:
«Ej, jam unë komandant!».
Asnjë nga shokët e tij
dorën s'do t'ia jepte e ta uronte.
Si të duronte ai?
Më keq jo, s'kish ku shkonte!
Në ëndërr bujkeshën, mjelësen, traktoristen kish parë,
por vajzën e tij
të veshur oficere

s'e kish ëndërruar.

Si do ta mbante pranë?

Mbi supet e brishta të Elës

si mbi dashurinë e pastër

po binte shi e llohë.

Pikërisht tani asaj i duheshin flatra

që të çahej nata dhe të shkonte.

Kështu biografinë e shoqes

s'e shkroi ajo, por unë

kur ishim larg në male

a buzë detit blu.

Të dielat vinin plot diell,

diellin në sy e kishim,

veç bija e bjeshkëve Ela

harroi ç'ishte e diela...

Kaluan pranvera, vera, vjeshta

dhe viti i tretë

si dielli në dritare

trokiti një mëngjes.

Diku nga një repart

komandanti vetë

i shkruante si shok i thjeshtë

dhe bashkë me të një zarf

që e shtangu Elën tonë.

«Ta hap të mos e hap?!».

Dhe dora e saj s'guxoi deri vonë.

Në fund e hapi dhe iu duk

se dora e saj që grisi atë zarf


kish grisur shpejt një natë,
një natë të errët shumë të gjatë.
Djaloshi ushtar
diku në jug
kish qeshur,
por kish provuar dhe dallgë
dhe nuk kish rënë në gjunjë.
Dikush e pat vënë re
që bluante përbrenda;
ushtarë e oficerë
u mblodhën gjith atje
siç mbledh fëmijët nëna,
siç hapet qielli në verë,
atje ishin hapur zemrat.
Nga zemrat kolektivi
flaku çdo bëzhdilë
dhe nisi këtë letër tek Ela
si një lajm të mirë.
Sot tek e kujtova
Elën, shoqen time,
në mendje krejt e solla
biografinë intime.
Sa herë që shkoj në bjeshkë,
dëgjoj si thërrasin Elën oficerë
dhe gëzoj, se nuk ka re,
dhe gëzoj, se kjo pranverë
s'ka fund për ne. . .

MOTIV NGA FUSHA

Dallgëzime blu deti sjell,
dallgëzim flori kjo fush' e artë.
Me krahë valësh deti më mbështjell,
flladi fushës përkëdhel ballë.

Er' e fushës
grurin valëzon,
me kallinjtë e grurit
mbledhim tufa rrezesh tok.

Do të futem përmes fushës flori,
nëpër dallgët e këtij deti do të hyj,
pushkëve të kulmuara buzë arës për ty
do t'u vë kurorë me kallinj.



ARKITEKTES

Çuditërisht gjithë njerëzit që kalonin në rrugën e re
ngrinin kokat lart si të dëgjonin zë nga qielli
dhe rrinin e kundronin ashtu si dhe unë
ballkonet, dritaret, ku tundte flokët e artë dielli.
Banorët e rinj ndiheshin të lumtur,
sikur të koloviteshin në djepin e kaltërsisë.
Unë i shikoja të gjithë, të gjitha i dëgjoja,
kur thoshin: «Bukur!»
Dhe më dukej sikur shqiptonin emrin tënd, shoqja
ime!
Pastaj erdhe ti, hipe, zbrite në pallat si një
kalimtare,
nuk re fare në sy, veçse ishe e emocionuar më shumë
se të tjerët,
në të vërtetë, ti aty merrje notën e «provimit të
parë».
Njerëzit vështronin sikur ti ëndrrat në qiell t'i kishe
përhapur.

PARA MAKETIT TË QYTETIT TIM

Qyteti im i ka rrënjët në lashtësi
e prapë në çdo pesëvjeçar ndryshon aq shumë
sa ndryshojnë ëndrrat e një fëmije të porsangritur
në këmbë,

sa ndryshojnë motivet në këngë.

Di rrugën ku u ngjit i pari trakt,

di sheshin ku u hodh në erë një tank,

i njoh ballin e larë në djersë

dhe me gëzim si askush shikoj projektin.

Po unë në këtë pesëvjeçar ç'projekt mund të kem?

Unë pjesë e qytetit tim dua të jem.

Kur ai gre më lart dhe një kat,

unë më tej duhet të hedh dhe një hap!

Kur ai ndërton një lagje të re,

dhe unë diçka dua të ngre!

Nuk di, po më buisin në shpirt

motivet si dallëndyshet që ndërtojnë fole.

GJURMË HEROIZMI

Nga zemra e tokës minatori Frrok
me pistoletë nxirrte bakër.

Bakër! Bakër nga galeritë e thella të minierës!
Kur në shtëpinë e babë Kolës u flak kandili
e dhoma u mbush plot dritë,
plaku i lumtur tha:

— Ja, në këto tela rrjedh dhe djersa e birit tim!
Një mbrëmje shtatori thirri Frrokun n'alarm.

Babë Kolës fleta e thirrjes i dogji në dorë.

— Im bir vazhdon turnin në zemrën e madhe të
tokës,

në këmbë të tij ushtar në rresht unë jam.

Babë Kola shihte djemtë ushtarë

që rrëmbyen armët në armaturë

e si mund të linte ai atje të mbetej një armë,

të mbetej pa mbrojtur një arë,

një arë plot grurë;

miniera ku Frroku punonte;

një shkollë, një urë?
Dhe pushkën rrëmbeu ai
si borigë e lartë,
babë Kola në rresht zuri vend.
E, tek ecte, mendonte pse i biri s'ish kthyer akoma;
ktheu kokën sikur Frroku ta thërriste në çast,
sikur emri i të birit diku u përmend.
Nga gryk' e minierës u ngrit
një dorë vigane e mbledhur grusht,
krahu i Frrokut u ngrit në zenit,
heroi nga larg buzëqeshte
gati për të rrokur besniken pushkë.
Dhe hapin e zgjati më shumë babë Kola
në shtigjet e kalitjes eci dit' e natë.

KATËR VARGJE PËR NËNËN

Qiellin e kaltër dhe botën pa fund
në sytë e nënës gjen.
Nga gjithë ç'ikin e s'kthehen kurrë
më shumë se nëna asgjë nuk dhemb!

*
* * *

Kur mbrëmja rrugët mbush me gjallëri
dhe yjet picërrojnë sytë atje lart,
një pyll kërkoi të shoh, një dashuri,
veç jo në qiell, po këtu mes njerëzve
varg.

*

*

*

Kërkoj fjalën e pathënë
të ta shpreh mendimin ty,
por papritur nderet heshtja,
kthjelltësi në tanët sy...

B L E R I M I

Sytë e luleve sa puthen me diellin e ngrohtë, çelin
sytha,
Siç çelin ëndrrat e mia kur vështrimin e atij takoj.
Dhe unë si një puhizë e lehtë nëpër sytha kaloj,
duke pritur që e para lule të çelë,
dashuria...

K U R . . .

Kur çel lulja në kopsht,
kujto ç'të thashë: Do vij te ti!
Zgjohu nga ëndrrat, mos fli,
me lulen do vij te ti.

Kur fëshfërijnë gjethet,
kupto, jam unë që vij te ti,
zgjohu nga ëndrrat, mos fli,
me gjethet do vij te ti.

Kur nis e piklon shi,
mendo se unë po vij te ti,
zgjohu nga ëndrrat, mos fli,
jam shiu që vij te ti.

Kur dimri hedh dëborën,
mos harro se prapë jam unë që vij te ti,
zgjohu nga ëndrrat, mos fli,
me petalen e borës po vij.

MBI THASHETHEMET

Ia fal unë gjyshes e tetos së mirë,
kur shqetësohen për mua sado më kot.
Mbetën ëndrrat e tyre si bisqe të pambirë
dhe dashurinë dje shijuan veç në lot.
Po sot kurrkujt s'ia fal unë sot
që me thashetheme si me tym të zi
të ma rrethojnë këtë ndjenjë të fortë
e kaq të pastër që quhet dashuri.

ME KË MË NGJAN TI...

Ti i përngjan rrezes së diellit
që të ngroh me vezullime.
Duke qëndruar kaq pranë,
lindin mijëra ëndrra, përfytyrime.

Ti i përngjan valës së detit
që bregun lehtas puth e shkrihet.
Fëmijë e vogël në trupin tim
e butë, e njomësht si zogth më hidhesh!

SI TË TË QUAJMË-

Mes dhimbjesh linde ti,
fëmijë e parë, sytë përgjysmë hapur.
Babai puth pëllëmbët grusht mbledhur
thonjtë e vegjël ngjyrë rozë dhe sytë e kaltër.

Buzët lëshojnë klithjet e para,
dehet qenia e nënës, mbushet me dashuri,
në çarçafët e bardhë ka çelur lulja e saj,
më e bukura lule rrethuar me dritë.

Si të të quajmë; pa emër erdhe ti,
në gji një ëndërr i fle nënës thellë
që kur dëgjoji të parën trokitje të saj
e deri sot në klithjen me poterë.

Si të të quajmë, moj lule e bukur,
një emër do marrësh sot nga ne,
por më të bukurin emër, më të mirë nesër
me punë e dituri vetes do t'ia gjesh...

I DUAM LULET

Në festa lule mbajmë në duar,
përshëndesim udhëheqësit.
Ditën e Dëshmorëve lule të freskëta
në mermerin e ftohtë vendosim.
Stinët e jetës sonë
çelin lulet më të bukura, fëmijët!
Me dashuri i rritim!

MAJË MALESH

Marshuam për tërë natën.

Në mëngjes qyteti hapi sytë pëllëmbëve tona.

Ishim ngjitur majë malesh.

Si malet kaq pranë shqiptari ka pasur luftën dhe
fitoren.

Kërkova më kot shkrepave të thepisur, honeve
nishan tërkuzash të gjysheve.

Në çdo hap më ndiqte kënga e shoqeve
dhe përplasja e krahëve të lirë në fluturimn' e
shqipes...

K U F I T A R I

VASIL SOTËS

Armiku përballë tij
me sytë e përgjakur
zhibirron errësirën
si egërsira gjahun.

Përse u drodhën gjethet?
Ç'ka pylli që gulçon?
Nuk është gjurmë zogu,
ç'të jetë, po përgjon...

Kjo erë ndaj mëngjesit
ç'i thotë, rri dëgjon....
Përse po tunden pemët,
ç'ka zemra që lufton?...

Nga larg ndihet një krismë,
pas pak ja dhe një,
dikush shkeli kufinë,
më afër vjen një zë

Nga gryk' e zezë e pushkës
armiku po vjell zjarr,
bisha kufitarin
qëllon për ta vrarë.

Por s'ikën kufitari
nga pozicioni i tij,
për kaltërsinë e ditëve
e jep gjakun ai.

Si shuhet gjuha flakë,
një plumb e merr në gji,
përkulet përmbi pushkë,
i qeshin sytë e zinj.

Sheh si lahet horizonti
në agimin e purpurt kristal,
përreth lulet e kaltra
i puthin yllin në ballë.

Pishat shkundën borën,
agimi hodhi rrezet,
mbi trupin e tij hodhën shokët
lulet e pranverës.

DITA E PARË E VITIT TË RI

Mbi valët rrëshqasin yjet dhe hëna,
detari kuvertës me pushkë përgjon,
deti me dallgë, valë të egra
një këngë e rrahur erërash brigjet i zgjon.

Gëzuar, vëllezër! Gëzuar Vitin e Ri!
Bromb gotat! Një vit të mbarë!
Me pushkë e dylbi horizontin ata
gjurmojnë e ngrenë dollinë e parë.

Gotat trokasin atje në anije,
valët përplasen direkt me zhurmë.
Gëzuar shokë! Një vit me suksese!
Anija jonë mposht çdo furtunë!

Mes kaltërsisë detarët urojnë,
mes ngrohtësisë detare: Gëzuar!
Tallazet e detit përplasen në gjoks:
Gëzuar shokë! Të gjithë gëzuar!

NË BRIGJET E FORTESËS

Ne të dy jemi ushtarë,
ushtarë të rinj në brigjet e fortesës,
mbi transhenë tonë si mbi një kitarë
derdhim notat e këngës me bulat e djersës.

Kjo kënga jonë dëgjohet kudo
përmbi stërkala, fëshfërima e rreze,
Atdheun me shpirt vërtet e do
kur ia ruan si dritën e syrit mëngjeset!

FJALË PËR SHOQET

Kjo poemë
mund të niste me emrin tënd.
Emri yt mund të ish
Liri,
Floreshë
siç mund të ish Margaritë...
Po unë desha që të gjitha ju,
gjyshe, nëna dhe motra,
t'ju quaj me emrin më të bukur e të thjeshtë:
Shoqe!
Përkulem para jush
e tëra,
me zemër,
me ndjenja,
me nerva
Përkulem dhe mbledh pikat e djersës,
pikat e gjakut
për të parë
si binte mbi kurrizin tënd aq rrëqethës

shkopi i poshtërimit,
për të parë se si bloza e oxhakut
nxinte në mushkëritë e tua të njoma.
Shoqe,
sa shumë t'u desh sa erdhi ajo ditë
që të të thërrasin kështu
dhe ti të ngrije kokën lart
e të gjithë të shikonin
se qielli paska qenë i kaltër aty në sytë e tu,
kurse ti në mugëllirë ishe endur më kot.
Të përtypnin ditët,
të përqeshnin netët...
Vetmia ish vdekja jote,
lumturia jote ish.
Qerpikët krihnin ëndrrat,
por ëndrrat llamburisnin dhe zhdukeshin në çast,
si një zog i bukur përherë në fluturim.
Ata që të kuptuan më mirë se kushdo,
lotin tënd e kishin dhe në syrin e tyre,
erdhën një mbrëmje dhe të thanë: Urdhëro,
të mësojmë një këngë,
për lumturinë tonë,
për lumturinë dhe të ardhmen e fëmijëve!
Netët ilegale
hynë në shekullin e netëve të tua.
Burrat që patën trimërinë tuaj aq pranë,
ata që emrin e ri «shoqe», shqiptuan,
për herë të parë kuptuan se krenaria

niste nga brazdat e thella të ballit tuaj.

Ata më mirë kuptuan

pse i grumbulloi me aq dashuri vështrimet tuaja

Partia,

pse kjo luftë që shtegtonte drejt lirisë,

drejt çlirimit të përjetshëm të gruas shqiptare

shtegëtonte,

drejt çlirimit të plotë, drejt kumbimit triumfal

tejedanë

Atdheut,

I grumbulloi vështrimet tuaja Partia,

siç grumbullohen retë e bardha dhe shtegtojnë drejt

detit,

përpara se të niste stuhia. . .

Ato vështrime stuhinë partizane

më të rreptë dhe më kushtuese e bënë.

Në netët e acarta

ju, gjyshe, nëna dhe motra, qepnit gjerdanë

sikur donit t'i mbushnit foletë e fishekëve plot

me brengat,

me dhimbjet,

me urrejtjen,

me këngët e belbëzuara,

me lot. . .

Në sofrat tuaja s'kish një thërrime miell,

por për partizanët ju gjetët çdo gjë,

sikur dëshirat tuaja i hidhnit në sitën e diellit

dhe buka për çlirimtarët e plotë u bë.

Shpesh ndodhi që plumbi
jua preu vrapin e rrufeshëm,
po më i egër niste atëherë sulmi,
shokët mbi armikun suleshin më të tmerrshëm.
Plagët s'u ndanë nga lufta,
plagët s'u ndanë nga kënga,
s'u ndanë nga ëndrrat...
Fjalët tuaja të fundit

«Të rrojë Partia»,

partizanët i sollën te ne.
Ato ishin fjalët e para tonat,
fjalët e para në ditët e çlirimit...
Kështu sulmi juaj s'u step,
sulmin tuaj e vazhduam ne;
dhe ne shoqe na thirrën djemtë,
ne filluam të mbillnim ëndrrat anembanë kësaj toke.
Shoqe!

Kujt i drejtohem kështu?

A e dëgjoni zërin tonë, Margaritë, Zonjë,
si ju dhe ne në sy kemi qiellin blu.

Vitet e betejave të punës në mijëra fronte
s'na lanë aty ku na gjetën,

po u ngritëm lart,

lart në këngë, në shpirt,

ku përmes dritave të skelave, me krenari
ju thërrasim juve, «shoqe»!

Ju duke ecur nëpër borë me këpucë ushtari
i mbanit sytë në këto ditë të bukura

dhe partizanët i ngrohte zjërri i këngës suaj
Dalngadalë po vjen behari»...
Sot ne jemi vetë ai behari i gjatë, i përjetshëm
i pranverave socialiste në Atdhe.
Duke trazuar krelat e një hidrocentrali,
duke e bërë të bukur si fushën dhe malin,
kemi shkruar një këngë të re:
«Parti, ndërtuese dhe ushtaret e tua na ke»!
Ne rrimë në transhe me vëllezërit ushtarë,
mbajmë lart vigjilencën grykave, shkrepare,
që të mos guxojë askush të na prekë truallin amtar,
që të mos guxojë askush të na djegë veprat,
që të mos guxojë askush t'jua prekë juve qetësinë.
Dhe besoni, në guxoftë ndonjë,
nuk do të jemi më pas nga ju në trimëri.
Dashuria për socializmin dhe popullin
na bën të mposhtim çdo stuhi. . .

PASQYRA E LËNDËS

Faqe

Rrugës për në punë	3
Te ju po vij ushtare	4
Ku gjej poezinë	5
Era e revolucionit	6
Në stërvitje dimri	7
Vitet nuk plakin trimërinë	8
Fqinjët	9
Vallja në tepsi	10
Bija e bjeshkëve	12
Motiv nga fusha	17
Arkitektes	18
Para maketit të qytetit tim	19
Gjurmë heroizmi	20
Katër vargje për nënën	22
Kur mbrëmja rrugët mbush me gjallëri	23
Kërkoj fjalën e pathënë	24
Blerimi	26
Kur	23
Mbi thashethemet	25
Me kë më ngjan ti	28

Si të të quajmë?	29
I duam lulet	30
Majë malesh	31
Kufitari	32
Dita e parë e Vitit të Ri	34
Në brigjet e fortesës	35
Fjalë për shoqet	36